



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
“PORTI DETAR” SH.A. SARANDË

**Shtojca 11**

Nr.409/12.Prot

Sarandë, më 24.09.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1**  
**( NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[24 Shtator 2024]

**Drejtuar: IMPACT SHPK**

*TIRANË Njësia Bashkiake nr.5, Rruga , Komuna e Parisit, pallati nr.4, dyqani nr.2.*

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapur- e thjeshtuar- Mallra”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-16347-08-15-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **"Mbulimi me kamera i territorit të Portit Detar SHA Sarandë, përfshirë terminalin, zyrat e administratës dhe kalatat"**

Kohëzgjatja e kontratës: 45 (dyzet e pesë) ditë, nga nënshkrimi i kontratës.

Fondi limit 2.998.641 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e një) Lek pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. ALComm Solution SHPK me nr. NUIS M01427004J, ofron vlerën sipas preventivit 2 435 466.
2. IMPACT SHPK, me nr. NUIS K81325001B, ofron vlerën sipas preventivit 2.788.543

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- ALComm Solution SHPK me nr. NUIS M01427004J për arsyet e mëposhtme
- Nuk përmbush kriterin 2.3.4, të kushteve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se:

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik për mallrat e ofruara, duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të

<sup>1</sup> Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime



katalogut/ëve të lëshuara ose publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë ose skedat teknike të lëshuara ose publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Në katalogun ose skedën teknike duhet të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, ku të gjëjmë pasqyrim për parametrat teknikë të produktit (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, përveç elementëve teknik specifik, termave në anglisht që përdoren ndërkombëtarisht, që janë vendosur në specifikimet teknike , me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Nga krahasimi I të dhënave teknike të materialeve të ofruare rezultojnë se nuk përmbushen specifikimet teknike të kërkuara për mallrat si më poshtë:

NVR:

Ndërfaqet e kërkuara për NVR: 2VGA / zgjidhja e Alcomm nuk i ka.

Nuk ka port eSATA.

Nuk ka porta RS232 dhe RS485.

Temperatura e operimit e kërkuar -10 deri në +50 grade, e ofertuar 0 deri në +50 gradë celsius.

Industrial Switch:

Temperatura e operimit e kërkuar -40 deri në +75 grade, e ofertuar -30 deri në +75 gradë Celsius

Kamerat:

Mungojne specifikimet për modelin "Fisheye";

Kamerat e ofertuara nuk janë bërë highlight specifikimet teknike në broshure. Pra nuk kuptohet cila kamer është ofertuar për secilin zë.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë IMPACT SHPK [TIRANË Njësia Bashkiake nr.5, Rruga , Komuna e Parisit, pallati nr.4, dyqani nr.2], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 2 788 543 (dy milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Shoqërisë Porti Detar SHA Sarandë me adresë: Lagjia Nr.4, Rruga Mitat Hoxha, Sarandë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit



është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Alket QËNDRO**